



---

**VENDIM**  
**Nr. 43 Date 31.05.2010**

**PËR**  
**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**  
**SHOQËRISË “FABRIKA E ÇIMENTOS FUSHE – KRUIJË” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 4 dhe 5 pika 2 të “Rregullores për Kriteret e Dhenies dhe Heqjes së Statusit të Klientit të Kualifikuar”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s nr.99, date 27.12.2006, dhe ndryshuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s nr. 17, datë 06.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.05.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fabrika e Çimentos Fushë - Krujë” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar,

**Konstatohet se :**

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe Vendimit nr.8, datë 29.01.2010 të Bordit të Komisionerëve ”Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Dhënie e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Fabrika e Çimentos Fushë - Krujë” sh.p.k.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**

**Bujar NEPRA**

---

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"10  
963  
Tirane  
69 590  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)